

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deonitarsko Društvo

Nr. 10625 Data. 22.12.2025
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në nenin 2 të Rregullores me nr. protokoli: 5156 të datës: 11.09.2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores me nr.2778 të datës 26.05.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça-Stan Tërg, si dhe në bazë të nenit 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., Trepça Sh.A me datë 22.12.2025 publikon këtë:

KONKURS

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Punëtor në Minierë
Koeficienti/Paga	611€ bruto
Nr. i kërkuar	25
Kohëzgjatja e emërimit	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit	22.12.2025
Afati për aplikim	23.12.2025-06.01.2026
Institucioni	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore	Minierat me Flotacion "Trepça"- Stan Tërg
Vendi i punës	Stan Tërg

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Ndiemon ngarkuesin në makinat CAVO, toro dhe kamion;
- Mbush vagonetat në oxhakun e xehes;
- Pastron korridoret e horizonteve, kanalet e ujit, vagonetat dhe makinat e tjera;
- Përcjell lokomotivën me vagonetat e mbushura ose të zbrazëta dhe informon përgjegjësin ose lokomotivistin për çdo ndryshim ose anomali;
- Kryen punë të tjera të caktuara nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë;
- I përgjigjet për punën e vet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë diplomë të shkollimit të mesëm të ulët;
- Të ketë së paku gjashtë (6) muaj përvojë profesionale;
- Përparësi kanë kandidatët e moshës nga 21- 40 vjeç.

- **Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit**

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

4. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

5. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/> , tek kategoria Shpallje.

6. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

7. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesit do të shpallen përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”.

Njoftim shitesë: Kandidatët e pranuar për një periudhë 5 vjeçare nuk mund të transferohen apo të sistemohen në pozita jashtë minierës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A.
Kryeshefi Ekzekutiv



Faton Ahmeti